



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINE
OPŠTINA KLINE



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

01Nr 06-15705 /25

Klinë, dt: 28. 05 /25

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dytë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur më 29.04.2025, me fillim nga ora 16:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e KKSBB-së, znj. Marqe Selmanaj, e cila përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe falënderoi anëtarët për bashkëpunimin dhe komunikimin e ndërsjellë, në funksion të përbashkët për sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve të komunës së Klinës.

Më pas, znj. Selmanaj prezantoi pikat e rendit të ditës, të cilat u trajtuan sipas radhës.

RENDI I DITËS

1. Analiza e gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Klinës;
2. Raportimi i Drejtorisë së Inspektoratit dhe çështja e qenve endacakë;
3. Ndriçimi publik dhe pengesat në trotuare;
4. Të ndryshme.

Pika 1: Analiza e gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Klinës.

Fjalën e mori Komandanti i Stacionit Policor në Klinë, z. **Ragip Bytyqi**, i cili përshëndeti të pranishmit dhe bëri një përbledhje të gjendjes së sigurisë për katër mujorin e parë të vitit 2025. Sipas tij:

- Situata e përgjithshme e sigurisë në komunë është stabile dhe e qetë.
- Kanë ndodhur 212 incidente, prej të cilave 115 vepra penale.
- Mbulueshmëria e rasteve është 88.4%, një përqindje shumë e kënaqshme.
- Janë evidentuar 104 aksidente trafiku: 20 me lëndime trupore dhe 81 me dëme materiale. Në total, 42 persona kanë pësuar lëndime trupore.
- Janë shqiptuar 3508 gjoba për kundërvajtje në trafik.
- Janë arrestuar 96 persona, nga të cilët 33 janë ndaluar. Janë konfiskuar 9 armë zjarri dhe rrith 800 copë municion i kalibrave të ndryshëm.
- Janë realizuar 25 asistime për institucionet e drejtësisë.
- Veprat më të rënda të evidentuara janë: 1 rast tentim vrasje, 2 lëndime të rënda trupore, 8 të lehta, 7 vjedhje, 18 vjedhje të rënda dhe 13 raste dhunë në familje.
- Janë realizuar: 492 patrullime në këmbë, 564 me vetura dhe 1415 pika kontrolli në të gjithë territorin e komunës.
- Në lidhje me aksidentet në afërsi të hekurudhave, janë ndërmarrë masa operative dhe taktike, përfshirë mbikëqyrjen me dronë dhe shqiptimin e gjobave. Vetëm gjatë javës së fundit janë shqiptuar 150 gjoba për mosrespektim të shenjave të komunikacionit.

Pika 2: Raportimi i Drejtorisë së Inspektoratit dhe çështja e qenve endacakë.

Fjalën e mori përfaqësuesi i Inspektoratit Komunal, z. **Skender Gashi**, i cili informoi:

- Të gjitha shenjat e komunikacionit janë të vendosura në mënyrë të rregullt, përfshirë zonat pranë hekurudhave.
- Në lidhje me qentë endacakë, është nënshkruar një kontratë me një operator ekonomik dhe ambulancë veterinarë në Riqevë, në vlerë prej 30,000 euro, për periudhën dyvjeçare (nga data 06.06.2023).
- Deri më tani janë trajtuar dhe sterilizuar 270 qenë endacakë.
- Është në procedurë nisja e një kontrate të re me vlerë të rritur në 50,000 euro.

Z. Josip Deda, komento lidhur me efektshmërinë e sinjalistikës dhe theksoi që aksidentet në hekurudhë janë rezultat i mungesës së vetëdijes së drejtuesve të mjeteve, jo i mungesës së shenjave.

Ai gjithashtu ngriti shqetësimin për shtyllat elektrike të vendosura në mes të trotuareve, veçanërisht në Krushevë të Vogël dhe mungesën e shenjave sinjalizuese në rrugën “Ndue Përlleshi”.

Komandanti Ragip Bytyqi sqaroi se projekt i përshtatshme për sinjalistikën është realizuar 100%, në bashkëpunim me anëtarët përkatës të komisionit.

Pika 3: Ndriçimi publik dhe pengesat në trotuare.

Fjalën e mori **Kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj**, i cili deklaroj:

- Këtë javë do të nënshkruhet marrëveshja për asfaltimin e rrugës nga Unaza “Nënë Tereza” deri në QKMF dhe rehabilitimin e trotuareve.
- Do të vendoset ndriçim publik përgjatë rrugës dhe do të ndërtohen trotuare të reja, përfshirë:
 - Nga Krusheva e Vogël deri në Zllakuqan.
 - Nga Stacioni i trenit deri në Pograxhë.
- Ka një marrëveshje bashkëpunimi me USAID për shtratin e lumit Drini i Bardhë (Zllakuqan – Guri i Zi), por projekt i përgjigjeje përvjetor përkohësisht me vendim të ish-presidentit Trump.

Z. Josip Deda kërkoi sqarime për shtyllat elektrike në lagjen e tij, që sipas tij janë vendosur gabimisht dhe përplasen me trotuaret.

Z. Elezaj sqaroi se këto probleme burojnë nga mungesa e bashkëpunimit të kompanisë KEDS, dhe se janë në pritje të një përgjigjeje përvjetore zhvendosjen e shtyllave në vendet e përshtatshme.

Pika 4: Të ndryshme.

Pastori Jeton Sokoli, i pranishëm në takim, ngriti një çështje në lidhje me gjendjen e një rezervuari të ujit nën menaxhimin e kompanisë “Hidrodrini”, të cilin e quajti “në gjendje mjeruese”.

Kryetari Elezaj theksoi se “Hidrodrini” nuk është nën kompetencën e komunës, por Inspektorati ka dalë në vendngjarje dhe është ndërmarrë veprimi i duhur për evitimin e problemit.

Komandanti Bytyqi shtoi se Policia raporton çdo zonë që përbën rrezik potencial për qytetarët dhe mbetet e gatshme të ndërmarrë veprimet e nevojshme.

Znj. Marqe Selmanaj përmbylli mbledhjen me një falënderim për të gjithë pjesëmarrësit dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejshëm në të mirë të qytetarëve të komunës.

Procesmbajtësja,
Vjosa Gjetaj



Zv. KRYESUESJA
Marqe Selmanaj

